

V E N D I M

Nr.36, datë 21.1.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.221, DATË 4.4.1998, NR.319, DATË 23.5.1998, NR.250, DATË 30.4.1998 DHE
NR.178, DATË 6.3.1998**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.221, datë 4.4.1998 “Për vënien në dispozicion të kompanisë administruese Deloitte & Touche të grupit të shoqërimit të policisë”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Për periudhën deri në fund të muajit mars 1999, në dispozicion të kompanisë administruese Deloitte & Touche të vihet grupi i shoqërimit me forca policie nga Ministria e Rendit Publik.”.

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Fondi i pagave dhe shpenzimet e tjera të eskortës së policisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.221, datë 4.4.1998, të përballohet nga Ministria e Rendit Publik brenda buxhetit të vitit 1999.”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.319, datë 23.5.1998 “Për kontrollin dhe administrimin e shoqërive huamarrëse, që janë në proces hetimi dhe gjykimi nga kompania Pricewaterhouse Coopers”, pika 7 ndryshohet si vijon:

“Kompanisë Pricewaterhouse Coopers, në ushtrimin e detyrës, për kontrollin dhe administrimin, deri në fund të muajit janar 1999, i vihet në dispozicion një grup shoqërimi, i përbërë nga një oficer dhe 2 punonjës policie, së bashku me një autoveturë. Fondi i pagave dhe shpenzimet e tyre përballohen nga buxheti i vitit 1999 miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 30.4.1998 “Për dhënie asistence ligjore kompanisë Deloitte & Touche, gjatë procesit të likuidimit të shoqërive huamarrëse”, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Kompanisë administruese Deloitte & Touche, për procesin e likuidimit të shoqërive tregtare, që kanë grumbulluar kapitale nga publiku i gjerë, i sigurohet asistencë ligjore deri në përfundimin e procesit të shitjes. Fondi i pagave përballohet nga buxheti i caktuar për Grupin Mbikëqyrës, në planin e vitit 1999.”.

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 6.3.1998 “Për caktimin e ekspertëve financiarë të pavarur në kontrollin e regjistrave ose të librave të shoqërive huamarrëse”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 2 ndryshohet si vijon:

“Si ekspertë financiarë të pavarur në subjektet e kontrollit të përmendur në pikën 1të vendimit, nga Grupi Mbikëqyrës caktohen 6-8 persona nga lista e personave që i

bashkëlidhet vendimit.”.

- Pika 9, ndryshohet si vijon:

“Fondi i pagave të grupit të eksperteve financiarë të pavarur përballohet nga buxheti i caktuar për Grupin Mbikëqyrës në planin e vitit 1999.”.

5. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko